




LIKA E SHQIPËRISË
E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË



NR. 7836 Regj.Them

Tiranë më 28.07.2020

NJOFTIM ME AFISHIM

Për njoftimin e te paditurit:

Endri Muçollari

Drejtuar:

Njesia administrative Maliq
Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tiranë.
Bashkisë Maliq
Adrese: Blloku Nr.1 Maliq

- Detyr. Tel. Ing. P. P. P.



Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është për gjykim çështja civile që i përket:

PADITËS: Shoqëria "TELEKOM ALBANIA" SHA (ish AMC SH.A)

IPADITUR: Endri MUÇOLLARI.

OBJEKTI: Detyrimin e të paditurit Endri Muçollari të paguajë shumën 516.398 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi telefonik celular.

Gjykata ka urdhëruar që njoftimi i te paditurit të bëhet me afishim bazuar në nenin 133/b paragrafi 2 të K.Pr.Civile, njoftimi drejtuar te paditurit ka ardhur me shënimin i panjohur.

Njoftohet pala e paditur Endri Muçollari se duhet të paraqitet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Zyrën me Nr.317, kati i trete që të tërheqë një kopje të njoftimit dhe të provave për të përpiluar më pas Deklaratën e mbrojtjes si dhe të paraqesë provat përkatëse.

Ky afishim zë vendin e njoftimit për palen e paditur dhe vendoset:

- Një kopje vendoset ne Njesine Administrative Maliq
- Një kopje vendoset ne Bashkise Maliq
- Një kopje vendoset në këndin e njoftimeve dhe ne faqen zyrtare te internetit te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
- Një kopje vendoset ne adresen e shtetases
- Nje kopje tjeter ruhet në dosje.

Bazuar në nenin 133 të K.Pr.Civile (i ndryshuar), kjo shpallje duhet të rrijë e afishuar, jo më pak se 20 (njëzet) ditë.

Me kalimin e 20 (njëzet) ditëve nga e nësërmja e afishimit, fillon afati 30 ditor që pala e paditur duhet të paraqesë deklaratën e mbrojtjes si dhe provat.

Deklarata e mbrojtjes hartohet nga i padituri në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

- Gjykatën përpara së cilës paraqitet deklarata e mbrojtjes;
- emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka. Nëse paditësi ose i

Nr. 103 Prot
Dt. 4.08.2020

padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;

- c) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka.

Bashkëngjitur deklaratës së mbrojtjes duhet të deklaroni qartë si më poshtë :

- a) Të dhënat e kontaktit tuaj elektronik ose të përfaqësuesve tuaj, nëse keni, të cilat gjykata mund t'i përdorë për t'iu njoftuar;
- b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, duke specifikuar saktë emrat e tyre, atësinë, mbiemrin, dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
- c) provat që kërkohen të merren tek të tretët ose tek paditësi, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave;
- ç) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjyqimit;
- d) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin e personit juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi;
- dh) kundërpadinë, kur kërkohet prej jush ushtrimi i kësaj të drejte, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

I padituri duhet të informojë gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik si dhe të përfaqësuesit të tij. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.

Ju bëjmë me dije se moslëshimi i deklaratës së mbrojtjes nga ana juaj së bashku me aktet përkatëse, sjell papranueshmërinë e prapësimeve dhe provave që paraqiten më vonë në këtë gjykim.

Ju bëjmë me dije se seanca përgatitore për zhvillimin e kësaj çështje civile do të zhvillohet më datë 22.10.2020 ora 10:00 ditë e Enjte.

GJYQTARE E ÇËSHTJES

Anila KARANXHA

